



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:327446

Datë: 20.02.2025

Numri i dokumentit: 06872671

**C.nr.1580/2024**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.B.mësimdhënëse në SHMFU "S." në fshatin B.-Komuna e Malishevës, të cilën me autorizim e përfaqësojnë avokatët Bestar Kolgeci dhe Flaka Gutaj që të dy nga Prizreni, me adresë rr. "De Rada", nr.04, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, të cilën e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, me objekt kontesti kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e shpenzimeve të ushqimit(shujtës) për ditët e pranisë në punë, me vlerë të kontestit 680.00 Euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 20.02.2025 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses L.B.mësimdhënëse në SHMFU "S." në fshatin B.-Komuna e Malishevës dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e shpenzimeve të ushqimit (shujtës) për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore nga data 01.07.2021 e deri me datë 21.11.2022, respektivisht për 220 ditë të pranisë në punë, paditëses së lartcekur t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 440.00 Euro (katërqind e katërdhjetë Euro) me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të fillojë të llogaritet nga data 02.07.2024 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.
- II. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses, përtej shumës së gjykuar sikurse në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e shpenzimeve të ushqimit (shujtës) për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore nga data 01.01.2021 e deri me datë 30.06.2021, respektivisht për 120 ditë të pranisë në punë, në shumën prej 240.00 Euro (dyqind e katërdhjetë Euro), **si e parashkruar**.
- III. DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses t'ia paguaj shumën e

përgjithshme prej 98.00 Euro (nëntëdhjetë e tetë Euro), në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Paditësja L.B.mësimdhënëse në SHMFU “S.” në fshatin B.-Komuna e Malishevës, në këtë gjykatë me datë 02.07.2024, përmes së autorizuarve të saj, Bestar Kolgeci dhe Flaka Gutaj që të dy avokatë nga Prizreni, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e shpenzimeve të ushqimit(shujtës) për ditët e pranisë në punë, duke theksuar se paditësja është e punësuar pranë të paditurës, si mësimdhënëse në shkollën SHMFU “S.” në fshatin B.-Komuna e Malishevës. Ka theksuar se të njëjtës nuk i është kompensuar nga e paditura obligimi për ushqimin për ditët e pranisë në punë për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datë 21.11.2022, andaj ka paraqitur padi ku ka kërkuar nga gjykata që të detyrojë të paditurën që të bëjë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit (shujtave), ashtu që për 340 ditë të pranisë në punë t’ia paguaj paditëses shumën e përgjithshme prej 680.00 Euro, duke kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses, e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura Komuna e Malishevës, përmes së autorizuarit të saj Mujë Sahitaj-avokat publik i komunës, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 24.12.2024, ku ka theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit për faktin se paditësja ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit(shujtën) nga data 20.11.2023, ndërsa kjo padi nuk është e bazuar fare në kontratën kolektive të arsimit pasi e njëjta është shkëputur nga MASHT-i me datë 21.11.2022, pra padia është paraqitur pas afatit ligjor derisa kjo Kontratë ka qenë në fuqi, pasi është parashtruar në vitin 2024. Ka shtuar se e paditura e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi kontrata kolektive e arsimit e lidhur mes SBASHKU-t dhe MASHT është shkëputur nga MASHT-i dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi, pasi palët të cilët e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta e nënshkruajnë këtë kontratë, e poashtu kontratës së njëjtë i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjitha kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK-un me datë 21.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate. Poashtu MAPL-ja ka bërë njoftimin për kryetarët e komunave me datë 22.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate nga MASHT-i për shkak të mungesës së bazës ligjore të kontratës kolektive, pasi nuk ka qenë e buxhetuar nga MEF-ja, pra kjo kërkesëpadi e paditësit tani nuk ka asnjë bazë ligjore në kontratën kolektive të vitit 2021. Ka theksuar se përmes kësaj padie të paditëses nuk është kërkuar sipas gjendjes faktike lidhur me llogaritjen e ditëve të punës për paditësen, ndërsa paditësja në këtë rast nuk e ka vlerësuar saktë gjendjen faktike siç është kërkuar në padi. Ka shtuar se meqenëse kjo kontratë tanimë nuk është në fuqi, pasi është shkëputur nga MASHT-i dhe ka qenë e lidhur nga kjo ministri, në këtë rast komuna e Malishevës-DKAE, këtu e paditura lidhur me këtë çështje kontestuese nuk ka pasur legjitimet pasiv në këtë procedurë por këtë legjitimet tani e ka MASHT. I ka propozuar Gjykatës që padinë

e paditëses ta e refuzoj në tërësi si të pabazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenit 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se paditësja M.K. është e punësuar tek e paditura në shkollën SHFMU “S.” në fshatin B.-Komuna e Malishevës dhe se në periudhën kohore nga 01.07.2021 deri me datë 21.11.2022, në shkollën SHFMU “S.” ka realizuar 220 ditë pune, fakt ky i vërtetuar përmes vërtetimit me nr. prot. 64/2023 të datës 26.12.2023 dhe vërtetimit me nr. prot. 65/2023 të datës 26.12.2023 të lëshuara nga drejtori i shkollës së lartcekur (*Vlen të theksohet se gjykata nga vërtetimi i shkollës së lartcekur të lëshuar për paditësen, e njëjta i kishte realizuar 155 ditë të pranisë në punë për periudhën kohore nga data 01.01.2021 e deri me datë 31.12.2021, mirëpo gjykata nuk ia njohu 120 ditë të pranisë në punë nga data 01.01.2021 e deri me datë 30.06.2021 për shkak se periudha e lartcekur në të cilën bazohet paditësja ka arritur parashkrimin, andaj për këtë periudhë të sipërcituar të ditëve të pranisë në punë si u tha më lartë paditëses së lartcekur gjykata ia refuzoj për shkak të parashkrimit të kërkesës*). Gjykata provës së lartcekur ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e saj, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk ishte kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në punë pranë shkollës SHFMU “S.” në fshatin B.-Komuna e Malishevës, ndërsa kontestuese mes palëve ndërgjyqëse rezulton të ishte e drejta në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën shpenzimeve të ushqimit(shujtës) për ditët e pranisë në punë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëses nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me nenin 35 par.7 të KKAK-së, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësja e cila ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 Euro), të të punësuarve për ushqim për t’ia bërë kompensimin”*, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj në emër të kompensimit të

shpenzimeve të ushqimit bëri përllogaritjen në atë mënyrë që për 220 ditët e pranisë në punë i ka shumëzuar me 2, duke ia njohur shumën prej 440.00 Euro, për periudhën kohore nga data 01.07.2022 e deri me datë 21.11.2022, për aq kohë sa ka qenë Kontrata Kolektive e Arsimit në fuqi.

Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, neni 90 par. 5 e që përcakton se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, e që nënkupton detyrimin e punëdhënësit përkatësisht, të paditurës për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, që prodhon efekt juridik për punëdhënësit që kanë të punësuar, sepse të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë dhe e paditura është punëdhënëse e paditëses prandaj detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës sa i përket asaj se padia e paditëses nuk ka bazë ligjore, mirëpo gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e shpenzimeve të ushqimit (shujtës) për ditët e pranisë në punë obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive dhe se kjo kontratë nuk është më në fuqi, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësja sipas padisë kërkon realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumat përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 02.07.2024, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj paditëses.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë së paditëses apo se padia është e pasafatshme, gjykata e vlerësoi se është pjesërisht i bazuar pretendimi i palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, shprehimisht theksohet që: *“Të gjitha*

*kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*". Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 02.07.2024, ndërsa kërkesa e saj ka qenë kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e shpenzimeve të ushqimit (shujtës) për ditët e pranisë në punë. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2021 deri më datën 30.06.2021, respektivisht 120 ditë të pranisë në punë, ndërsa paditësja e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe kanë ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë. Më konkretisht sipas përlllogaritjes së gjykatës kërkesa e parashkruar e paditëses rezulton të jetë në shumë prej 240.00 Euro. Andaj, mbi këtë gjykata e aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses sikurse në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit.

Andaj, nga të lartcekurat gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: *"Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia"*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se: *"Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura"*.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, që i referohet shumës prej 78.00 Euro për përpilim padie (*Për kontestet e vlerës së vogël për një paditës - nën shumën prej 500.00 Euro sipas nenit 485.1 të LPK-së*) dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20.00 Euro (*e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore*).

Prandaj, gjykata nga arsyet e cekura si më lart, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK-së, ashtu që vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORË NË GJAKOVË- DEGA NË MALISHEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.1580/2024, me datë 20.02.2025**

**G j y q t a r j a**  
**Hatixhe Begaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.